



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.850 /2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ali Tafarshiku antarë i kryesisë, të subjekti politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pasafatshme ankesa e Ali Tafarshiku antarë i kryesisë, të subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me shenjën ZL.Anr.850/2017 e datës 10.11.2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 10.11.2017, ka pranuar një ankesë nga Ali Tafarshiku antarë i kryesisë, të subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me të cilën pretendon se në ditën e votimit në vendvotimin 0202c/06R, kryesuesi i këtij vendvotimi nga subjekti politik AAK ka inicuar mbushjen e fletvotimeve të papërdorura duke ju ofruar secilës përfaqësues të partive politike ndarje të fletvotimeve të mbetura.

Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë fletvotim nuk është përfaqësuar nga asnjë komisioner por ka pasur vetëm një vëzhgues me të cilën nuk i është lejuar që ta shkruaj rastin në librin e ankesave.

Në vazhdim parashtruesi i ankesës pretendon se në vendvotimin 0214c/04d, po ashtu kryesuesi i këtij vendvotimi ka qenë nga subjekti politik AAK me të cilën pas numërimit të fletvotimeve ka kërkuar të mbushen fletvotimet e papërdorura në marrëveshje me komisionierët e tjerë, me të cilën thekson se janë njoftuar nga vëzhguesi i tyre.

Parashtruesi i ankesës pretendon se në vendvotimin 0202x/21d, një votues është ankuar se në librin e nënshkrimeve ka qenë rubrika e tij e nënshkruar nga dikush tjetër.

Kërkon nga PZAP – i të bëhet verifikimi i rasteve dhe rinumërimi i këtyre vendvotimeve.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa, e njëjta është pranuar nga PZAP me datën 10.11.2017. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në ankesën ZL.Anr.850/2017 të datës 10.11.2017, ndërlidhet me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar me datë 10.11.2017 në PZAP, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë në kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.850 2017 më datën 12.11.2017

Kryesnesi i Panelit
Gjytene Sylejmani



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.